

STATUT
i Shoqërisë tregtare **“METAL NET” sh.p.k**

Sot më datë 03/09/2025

Kreu I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Forma ligjore dhe emri i shoqërisë

- 1.1. **“METAL NET” sh.p.k** është themeluar bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, si dhe në Aktin e Themelimit të Shoqërisë nënshkruar nga Ortakët Themelues.
- 1.2. **“METAL NET” sh.p.k** është themeluar dhe funksionon si shoqëri tregtare e formës "me përgjegjësi të kufizuar" (sh.p.k). Nga këtu e mëposhtë në këtë Statut shoqëria **“METAL NET” sh.p.k** do referohet shkurtimisht "Shoqëria".
- 1.3. Shoqëria fiton personalitetin juridik si dhe të drejtën për të kryer veprime dhe të marrë përsipër të drejta dhe detyrime gjatë aktivitetit të saj të përditshëm, që nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar.
- 1.4. Shoqëria e realizon aktivitetin e saj, sipas objektit të përcaktuar na këtë Statut, bazuar në Legjislacionin Shqiptar, Statutin dhe Aktin e Themelimit.


Neni 2

Ortakët e shoqërisë

- 2.1. Shoqëria është themeluar nga 3 ortakë, z.Arben Ahmet Mema, z.Lauren Ideal Sheshi dhe z.Arbnor Astrit Shehu.



1



2.2. Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë deri në vlerën e kuotave të kapitalit themeltar që zotërojnë.

Neni 3 Kohëzgjatja

3.1. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

3.2. Afati i përmendur në pikën 1 të këtij neni mund të shkurtohet apo zgjatet me vendim të Asamblesë së Përgjithsme, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ky Statut.

Neni 4 Selia

4.1. Selia e Shoqërisë është në adresën: Durrës, Rruga Dituria, Shkozë, Durrës, Zona Kadastrale 8516, Nr.Pasurisë 10/234.

4.2. Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.


Neni 5 Objekti i aktivitetit

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë do të jetë:

- Import, eksport, tregtim me shumicë e pakicë, prodhim përpunim dhe riciklim i; çdo lloj metali dhe aliazheve të tyre si, hekur, çelik, inoks, alumin, bakër, plumb, zink etj; nënprodukteve, gjysëmprodukteve dhe produkteve të gatshme metalike; makinerive dhe pajisjeve industriale, bujqësore, ndërtimore dhe transportuese, si dhe pjesëve të këmbimit për to; mallrave të ndryshme, industriale, ushqimore, bujqësore, blegtorale, etj;



2



Kreu II

KAPITALI DHE KUOTAT

Neni 6

Kapitali themeltar

- 6.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë.
- 6.2.-Z.Arben Mema zotëron 33.34% të kuotave të kapitalit përcaktuar nga kontributi në para 33 340 lekë ;
-Z.Lauren Sheshi zotëron 33.33 % të kuotave të kapitalit përcaktuar nga kontributi në para 33 330 lekë ;
-Z.Arbnor Shehu zotëron 33.33 % të kuotave të kapitalit përcaktuar nga kontributi në para 33 330 lekë.
- 6.3. Kuotat janë nominative dhe nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë.
- 6.4. Cdo kuotë përfaqëson të drejtën e një vote.

Neni 7


Regjistri i kuotave të kapitalit themeltar

- 7.1. Kuotat dhe zotëruesi i tyre, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me kuotat e kapitalit themeltar, regjistrohen në një regjister të posaçëm.
- 7.2. Forma dhe modalitetet e tjera të regjistrimit miratohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme me votat e ortakëve që zotërojnë më shumë se $\frac{3}{4}$ e kuotave.

Neni 8

Fitimi dhe kalimi i kuotave të kapitalit

- 8.1. Fitimi dhe kalimi i kuotave të kapitalit bëhet sipas përcaktimeve të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 « Për tregtarët dhe shoqëritë tregëtare ».



8.2 Kalimi i kuotave të kapitalit tek ortakët e tjerë, të cilët kanë të drejtën e parablerjes, mund të bëhet lirisht. Kalimi i kuotave tek personat e tretë mund bëhet vetëm nëse miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me votat e ortakëve që zotërojnë më shumë se $\frac{3}{4}$ e kuotave.

Neni 9

Kalimi i kuotave të kapitalit me trashëgimi

9.1. Kuotat e kapitalit mund të transferohen lirisht dhe pa asnjë klauzolë kufizuese në këtë Statut, nëpërmjet trashëgimisë, si dhe midis bashkëshorteve në rast ndarje pasurore.

9.2. Kuotat e kapitalit mund të transferohen lirisht dhe pa asnjë klauzolë kufizuese në këtë Statut, midis bashkëshortëve si dhe midis prindit dhe fëmijës ose anasjelltas.

Neni 10

Akti i transferimit të kuotave të kapitalit

10.1. Në çdo rast, transferimi i kuotave të kapitalit me vullnetin e ortakut, duhet të vërtetohet nëpërmjet një akti noterial.


10.2. Trasferimet e kuotave të kapitalit pasqyrohen në regjistrin e posaçëm të miratuar sipas nenit 7 të këtij Statuti. Mos pasqyrimi i transferimit të kuotave të kapitalit në këtë regjistër, nuk e bën të pavlefshëm aktin e transferimit.

10.3. Akti i transferimit të kuotave të kapitalit duhet të depozitohet në Regjistrin Tregtar jo më vonë se një muaj nga data e regjistrimit të këtij akti në zyrën noteriale përkatëse.

10.4. Kërkesa për depozitim të aktit të shitjes së kuotave të kapitalit mund të bëhet nga shitësi ose nga blerësi, ose prej përfaqësuesve të tyre të autorizuar.

Neni 11

Zmadhimet e kapitalit me anë të kontributeve në para



Kapitali themeltar i shoqërisë mund të zmadhohet me kontribute në para me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 12

Zmadhimi i kapitalit me ane te kontributeve ne natyre

12.1. Zmadhimi i kapitalit themeltar nëpërmjet kontributeve në natyrë bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

12.2. Vlera e kontributit në natyrë si shtesë e kapitalit themeltar përcaktohet nga një ekspert i cili emërohet nga Asambleja e Përgjithshme.

12.3. Të dhënat mbi kontributin në natyrë të shtuar si pjesë e kapitalit themeltar regjistrohen në Regjistrin Tregtar.

Kreu III

ORGANET DREJTUESE DHE TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË

Neni 13

Organet drejtuese

Organet drejtuese të Shoqërisë janë:


- a. Asambleja e Përgjithshme;
- b. Administratori.

Neni 14

Asambleja e Përgjithshme kompetencat

14.1. Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca:

- a. ndryshimet në dispozitat e statutit;
- b. caktimi dhe shkarkimi i administratorit;



- c. caktimi dhe shkarkimi i ekspertit/ekspertëve kontabël si dhe likuidatorit/likuidatorëve;
- d. miratimi i raporteve të administrimit dhe kontrollit;
- e. miratimi i raportit vjetor;
- f. shpërndarja e dividendëve;
- g. ndryshimi i kapitalit themeltar;
- h. transferimi i kuotave të kapitalit themeltar tek palët e treta;
- i. likuidimi dhe/ose shndërrimi i shoqërisë. në një formë tjetër

Neni 15 **Administratori**

15.1. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:

- a. të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- b. të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c. të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d. të kryej detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut;
- e. Miraton pagat mujore të gjitha kategorive të punëmarrësve, në përputhje me tabelën e pagave të miratuar;
- f. të përgatisë nënshkruaj dhe paraqiejë para Asamblesë së Përgjithshme për miratim, bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures së veprimtarisë së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;

15.2. Mandati i Administratorit të shoqërisë është 5 (pesë vjet) me të drejtë rizgjedhjeje;

15.3. Administrator i shoqërisë emërohet ortakut Z.Arben Ahmet Mema.

NENI 16 **Bilanci i shoqërisë dhe dividendët**

16.1. Brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Përgjithshme miraton bilancin e paraqitur nga Adminstratori.

6



16.2.Asambleja e Përgjithshme vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar

NENI 17
Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me këtë statut dhe bazuar në përcaktimet e ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 « Për tregtarët dhe shoqëritë tregëtare »

ORTAKËT

ARBEN MEMA

LAUREN SHESHI

ARBENOR SHEHU

ARBEN MEMA Lauren Sheshi

ARBENOR SHEHU